



OJQ TOKA

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale
për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

5

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

6

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË GJENDJEN E FONDEVE

7

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

8

SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE

9

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar menaxhmentit të TOKA

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të TOKA, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të TOKA më 31 dhjetor 2023 dhe të performancës financiare dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin financiar që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Ligjet aktuale në fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdijë Organizatën, ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim

i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet tjera dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe. Ne marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se i atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinionin mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Organizatës.
- E vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me qasjen e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.



Astrit Musa – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
15 mars, 2024

TOKA

Pasqyra e pozicionit financiar

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

		Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
ASETET	Shënimi		
Asetet qarkulluese			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	3	157,312	230,315
Avanset e dhëna	4	-	1,658
Totali i aseteve qarkulluese		157,312	231,973
TOTALI I ASETIVE		157,312	231,973
DETYRIMET DHE REZERVAT			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme	5	16,678	5,434
Detyrimet nga të hyrat e shtyra	6	140,634	226,539
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		157,312	231,973
Gjendja e fondeve			
Fondi 01.01.2022		-	-
Teprica/(Mungesa) për vitin		-	-
Gjithsej gjendja e fondeve		-	-
TOTALI I FONDEVE DHE DETYRIMEVE		157,312	231,973

Pasqyrat financiare të përgaditura dhe aprovuara janë nënshkruar më 15 mars 2024 nga:

Jehona Gjugjeala



Drejtoreshë Ekzekutive



Granit Zhubi



Menaxher Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

TOKA

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

		Fundi i vitit 31 Dhjetor 2023	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2022
	Shënimi		
Të hyrat			
Të hyrat	7	<u>363,975</u>	<u>381,963</u>
Totali i të hyrave		363,975	381,963
Shpenzimet			
Shpenzimet e pagave	8	147,282	154,919
Shpenzimet programore	9	184,309	201,021
Shpenzimet administrative	10	<u>32,384</u>	<u>26,023</u>
Totali i shpenzimeve		363,975	381,963
Pjesa e mbetur		<u>-</u>	<u>-</u>

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

TOKA

Pasqyra e ndryshimeve në gjendjen e fondeve

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Teprica/Mungesa e akumuluar	Gjithsej
Pasqyra e Tepricave/Mungesave		
Më 1 janar 2022	-	-
Teprica (mungesa) për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	-	-
Më 1 janar 2023	-	-
Teprica (mungesa) për vitin	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	-	-

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

TOKA

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2023	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2022
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
Teprica(Mungesa) neto për vitin	-	-
Rregullimet për:		
Zhvlerësimin	-	-
Shpenzimet financiare	-	-
	-	-
<i>Lëvizjet në kapitalin punues:</i>		
Të arkëtueshmet	-	-
Avanset	1,658	39,835
Të pagueshmet	11,244	2,325
Detyrimet	(85,905)	(11,882)
Rrjedha e parasë neto nga aktivitetet operative	(73,003)	30,278
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	-	-
Blerja e paisjeve	-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese	-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Pranimi/Pagesa-Teprica/Mungesa e mjeteve	-	-
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese	-	-
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	(73,003)	30,278
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	230,315	200,037
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	157,312	230,315

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 12 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

1. INFORMATAT GJENERALE

ORGANIZATA KOSOVARE PËR TALENT DHE ARSIM (TOKA) është regjistruar si një Organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse sipas Ligjit Nr. 03 / L-134 për Lirinë e Shoqatave në Organizatat Jo-Qeveritare të Republikës së Kosovës, me regjistrim zyrtar nr. 5200286-9 më 17 dhjetor 2013.

Numri fiskal i TOKA është 601247788 dhe numri i Statusit të Përfituesit Publik 6001178-8.

Selia e Organizatës është Rr. "Meto Bajraktari" 4-1, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Të përgjithshme

Misioni i Organizatës është që të zhvillojë potencialin e rinisë kosovare, rajonit dhe diasporës.

Për të arritur këtë qëllim, organizata do të përqendrohet, pa u kufizuar, në këto aktivitete:

- Ofrimi i programeve të ndryshme arsimore përfshirë programet rezidenciale;
- Organizimi i njësive të lëvizshme arsimore për të arritur të rinjtë rurale;
- Trajnimi dhe fuqizimi i të rinjve në udhëheqjen e programeve inovative të arsimit;
- Trajnimi i të rinjve nga diaspora me qëllim të trajnimit personal dhe njohjes më të mirë të Kosovës dhe rajonit.

Programet e organizatës janë të ndara në dy shtylla:

1. Edukimi dhe zhvillimi i të rinjve - përqendrohet në zhvillimin e udhëheqjes personale, aftësive shoqërore, edukimit qytetar dhe ndërgjegjësimit mjedisor.
2. Vullnetarizmi arsimor i të rinjve në komunitet - synon stimulimin dhe inkurajimin e të rinjve për t'i shërbyer komunitetit me njohuri të reja, vetëbesim dhe aftësi të zhvilluara në programet TOKA.

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Baza e përgaditjes

2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë

2.1.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare për organizatën janë përgaditur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

2.1.3. Valuta funksionale dhe e prezantimit

Valuta funksionale e organizatës si dhe e prezantimit të pasqyrave financiare është Euro ("EUR"), e cila është valuta kryesore në Republikën e Kosovës që nga 1 janari 2002.

2.1.4. Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me ligjet aktuale në fuqi, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.1.5. Parimi i vijueshmërisë

Pasqyra e pozicionit financiar dhe ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon se organizata do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe t'i mbulojë detyrimet, gjatë rrjedhës normale të operimit.

2.2. Politika të rëndësishme kontabël

2.2.1 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.

Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë transaksione të ndërmarra nga organizata në një valutë të ndryshme nga valuta e saj funksionale. Transaksionet në valutë të huaj përkthehen në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

2.2.2 Njohja e te hyrave

Të hyrat njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të hyrave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

2.2.3 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njuh si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktiv apo të i njuh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.2.4 Shpenzimet

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit

2.2.5 Provizionet dhe detyrimet e papritura (kontingjente)

Detyrimet e papritura nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

3.PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Gjendja e parasë në bankë	156,811	230,302
Gjendja e parasë në arkë	501	13
Total paraaja dhe ekuivalentet e parasë	157,312	230,315

4. AVANSET

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Avanset e dhena tek partneret	-	1,658
Total avanset	-	1,658

5. LLOGARITË E PAGUESHME

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Fundatia Noi Orizonturi Lupeni	6,921	2,346
MU INTERAKTIVNE OTVORENE SKOLE	4,651	1,658
NVO FORUM MLADI I NEFORMALNA EDUKACIJA	3,917	-
World Vision Kosova	1,059	1,059
Online Sh.P.K.	97	9
IPKO Telecommunications L.L.C	33	30
Papirun Express SHPK	-	35
Obligimet për pagat neto	-	298
Total llogari të pagueshme	16,678	5,434

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

6. TË HYRAT E SHTYRA

	Te hyrat e shtyra nga 2022	Të pranuara në vitin 2023	Shpenzimet në vitin 2023	Te hyrat e shtyra për vitin vijues
UNRESTRICTED FUNDS	66,976	12,424	27,325	52,075
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2023	-	36,082	4,089	31,993
Smart Balkans 2023	-	28,556	-	28,556
Community Development Fund - CDF	47,074	7,940	45,870	9,144
Komuna e Prishtinës	-	10,000	3,144	6,856
CZOR - HERO	21,394	5,855	22,107	5,142
ERASMUS+	27,696	22,977	45,913	4,759
Depozitat HERO	4,945	-	300	4,645
KK Skenderaj	-	5,000	673	4,327
KCSF CEA	-	4,500	1,800	2,700
Soldarity Day	-	6,397	4,253	2,144
Associao Check IN	340	-	-	340
MAX TRAVEL L.L.C	-	955	856	99
PRISHTINA MUNICIPALITY	26	-	-	26
Solidar Suisse	-	44,805	44,805	-
KCSF	19,305	22,874	42,179	-
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2022-1	4,512	-	4,512	-
KK Deçan	-	500	500	-
KK Klinë	-	200	200	-
KK Podujevë	-	500	500	-
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	-	21,000	21,000	-
ALBANISCHE STUDENTEN STUTTGART	-	7,000	7,000	-
Banka Për Biznes SH.A.	-	1,200	1,200	-
FINCA Kosovo	-	500	500	-
KK Pejë 2023	-	500	500	-
KK Istogu	-	400	400	-
EUROPEAN COMISSION - FPA 2022	(6,297)	7,285	1,000	(12)
EUROPEAN COMISSION - EIDHR	(7,422)	8,398	1,000	(24)
Erasmus+ 2023	-	-	280	(280)
Smart Balkans Regional	-	17,749	20,931	(3,183)
EUROPEAN COMISSION - FPA 2023	47,992	-	51,847	(3,855)
GIZ	-	4,473	9,290	(4,817)
Total të hyrat e shtyra	226,539	278,070	363,975	140,634

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

7. TË HYRAT

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
EUROPEAN COMISSION - FPA 2023	51,847	-
ERASMUS+	45,913	44,082
Community Development Fund - CDF	45,870	52,842
Solidar Suisse	44,805	40,420
KCSF	42,179	44,307
Fondet e pakufizuara	31,878	11,554
CZOR - HERO	22,107	68,146
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	21,000	-
Smart Balkans Regional	20,931	-
GIZ	9,290	-
Albanische Studenten Stuttgart	7,000	-
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2022-1	4,512	-
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2023	4,089	-
Komuna e Prishtinës	3,144	3,000
Municipalities KK 2023	2,773	-
KCSF CEA	1,800	-
Banka për Biznes	1,200	-
EUROPEAN COMISSION - EIDHR	1,000	44,161
EUROPEAN COMISSION - FPA 2022	1,000	53,416
MAX Travel L.L.C.	856	-
Finca Kosovo	500	-
Erasmus+ 2023	280	-
EUROPEAN COMISSION - FPA 2021	-	988
KK Pejë 2022	-	500
KK Fushë Kosovë 2022	-	400
Istog 2022	-	200
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2021	-	4,908
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 2022	-	7,454
Zyra e Presidencës së Kosovës	-	5,584
Total të hyrat	363,975	364,017

8. SHPENZIMET E PAGAVE

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Shpenzimet e pagave	140,269	147,542
Shpenzimet e Kontributit të Punëtorëve	7,013	7,377
Total shpenzimet e pagave	147,282	154,919

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

9. SHPENZIMET PROGRAMORE

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Grantet për partnerët	43,207	72,654
Konsulentët	43,010	31,781
Shpenzimet e udhëtimit	26,209	26,139
Kostot e kampeve	17,364	17,735
Takime, Workshope, Trajnime	14,916	15,843
Tarifa e ekspertit	11,040	9,153
Grante të vogla	10,582	8,939
Kostot e konferencës	7,760	-
Printime dhe botime	7,238	7,427
Pajisjet	1,948	1,306
Promocione dhe Dizajn	912	5,350
Kostot e përkthimit	75	436
Zhvillimi i faqes në internet	48	1,548
Akomodimi	-	2,710
Shpenzimet e drejtpërdrejta programore	184,309	201,021

10. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Kostot e qirasë	10,549	10,549
Auditim, shërbime profesionale	5,500	1,500
Ujë, mbeturina dhe energji elektrike	3,790	3,866
Shpenzime zyre-materiale	3,107	2,273
Promovimi	3,044	2,044
Tarifat e anëtarësimeve dhe librave në internet	1,322	1,151
Telekomunikacioni	1,273	1,102
Dispozitat bankare	1,252	1,226
Mirëmbajtja	1,216	1,105
Karburant	684	462
Siguria	494	534
Të tjera	150	-
Postë	-	210
Total Shpenzimet administrative	32,384	26,023

TOKA

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

11 KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET

11.1. Çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023 organizata nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

12 NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.